



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 721/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr. “Armend Daci” nr. 1 Prishtinë, kundër debitorit K... sh.p.k., me NRB, me seli në Gjakovë, Raqë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.472/2021, të datës 22.07.2021, të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit K... sh.p.k. dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.472/2021, i datës 22.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, për pjesën me të cilën ka kërkuar interesin mujor në lartësi prej 2 (dy) %.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.472/2021, i datës 22.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 34,715.08 € (tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë euro e tetë cent).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndaj debitorit K... sh.p.k., sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.472/2021, të datës 22.07.2021, të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, për pjesën me të cilën ka kërkuar interesin mujor në lartësi prej 2 (dy) %.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat Gjokë Radi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 22.07.2021, ka lëshuar urdhrin përmbareimor P.nr.472/2021, me të cilin ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit përmbareimor Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr. 5289, të datës 14.12.2020, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën e borxhit prej 34,715.08 €, në emër të mos pagesës të rentës minerare, duke përfshirë edhe rrjedhën e interesit mujor prej 2%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhet shpenzimet e procedurës përmbareimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se propozimi për përmbareim nuk i ka përmbushur elementet e kërkuara me nenin 40.1 të LPP –së dhe 40.2 të LPP –së, ashtu që përmbareuesi privat ose gjykata janë të obliguara që konform nenit 40.2 të LPP –së, një propozim të tillë ta hedhin poshtë. Ka shtuar se sipas propozimit të përmbareim të kreditorit bazohet në aktvendimin Nr.5289 të datës 14.12.2020, me vërtetimin e përmbareueshmërisë të vërtetuar nga vet kreditori gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 22 të LPP –së. I ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit si i bazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak se prapësimi i debitorit nuk përmban kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP –së, ku në bazë të nenit 69 par 5 prapsimi kundër vendimit përmbareues mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të LPP –së. Në fund gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbareimor P.nr.472/21 të dt. 22.07.2021 i lëshuar nga Përmbareuesi Privat Gjokë Radi në Gjakovë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji

Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktvendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr. 5289, të datës 14.12.2020, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu vendimi, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”,* pasi që janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbartje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr. 5289, i datës 14.12.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organi përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr. 5289, i datës 14.12.2020, është bërë i formës së prerë me datë 28.01.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 13.02.2021.

Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përmbartimor P.nr.472/2021, i datës 22.07.2021, të Përmbartuesit Privat Gjakë Radi, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e interesit mujor në lartësi prej 2 %, dhe gjeti se urdhri përmbartimor i lejuar për këtë pjesë, nuk është në përputhje

më dokumentin përbarimor, pasi që me dokumentin përbarimor debitori është obliguar që të paguaj shumën 34,715.08 €, për rentën minerare, mirëpo jo edhe interesin mujor prej 2% dhe si rrjedhojë gjykata urdhrin e shfuqizoi pjesërisht dhe e përfundoi pjesërisht procedurën përbarimore sa i përket pjesës së interesit të kërkuar.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.721/22, datë 30.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.